



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E TRAJNERËVE NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2025



Në bazë të Nenit 9, alineja 1.3. dhe Nenit 33 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe në pajtim me Ligjin nr. 08/L-277 për Sport, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 20.08.2025, miraton këtë:

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E TRAJNERËVE NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

KAPITULLI I: QËLLIMI, PËRKUFIZIME DHE KUSHTET PËR LICENCIM

NENI 1: QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

Kjo Rregullore ka për qëllim të sigurojë një sistem të qartë dhe transparent për licencimin, rinovimin, dhe kontrollin e punës së trajnerëve që marrin pjesë në sportin e basketbollit në Republikën e Kosovës.

Me këtë Rregullore përcaktohen statusi i trajnerit të basketbollit, kushtet për licencim, procedurat për lëshimin dhe mbrojtjen e kontratave të trajnerëve, si dhe dispozitat disiplinore për anëtarët e Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (në vijim: SHTBK).

NENI 2: PËRKUFIZIME

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) është organi i vetëm përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e garave të basketbollit në të gjitha nivelet në territorin e Republikës së Kosovës.

Në kuptim të kësaj Rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë domethënie:

- **Trajner** – Personi që në përputhje me Ligjin për Sport, Statutin e FBK-së dhe këtë Rregullore kryen veprimtarinë profesionale të përgatitjes, drejtimit dhe udhëheqjes së basketbollistëve/eve në gara zyrtare në të gjitha nivelet e garave të organizuara nga FBK dhe posedon licencë valide të lëshuar nga FBK.
- **Licencë** – Dokumenti zyrtar i lëshuar nga FBK, si organi i vetëm përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e garave të basketbollit në të gjitha nivelet në territorin e Republikës së Kosovës. Licenca është dëshmi e kualifikimit profesional të trajnerit dhe shërben si autorizim për ushtrimin e funksionit të trajnerit në përputhje me nivelin e kategorisë dhe afatin e përcaktuar nga FBK. Licenca është e



detyrueshme për të gjithë trajnerët që ushtrojnë funksione në klubet që marrin pjesë në garat zyrtare të FBK-së.

- **Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK)** – Organ përfaqësues i trajnerëve të basketbollit në Kosovë, përgjegjës për organizimin profesional të seminareve, trajnimeve të ndryshme, përfaqësimin e interesave të trajnerëve dhe bashkëpunimin me FBK në procesin e licencimit dhe edukimit të vazhdueshëm.
- **Sezoni garues** – Periudha zyrtare njëvjeçare gjatë së cilës zhvillohen aktivitetet sportive të aprovuara nga FBK, zakonisht nga muaji shtator deri në qershor të vitit vijues.
- **Klub** – Entitet i regjistruar në përputhje me Ligjin për Sport i licencuar nga FBK për të marrë pjesë në garat e basketbollit në Kosovë dhe që punëson trajnerë të licencuar sipas kësaj Rregulloreje.
- **Seminar i detyrueshëm** – Program edukimi i organizuar nga FBK /SHTBK ose në bashkëpunim me partnerë të akredituar që synon zhvillimin profesional të trajnerëve dhe që përbën kusht për tu pajisur me licencë.
- **Licencë e përkohshme** – Licencë emergjente dhe e kufizuar në kohë e lëshuar nga SHTBK me miratimin e FBK-së në raste të veçanta për të mundësuar mbulimin e përkohshëm të pozitës së trajnerit në klub.

NENI 3: KUSHTET PËR LICENCIM

Për të aplikuar për licencë si trajner, kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeçare;
2. Të plotësojë njërën nga këto:
 - 2.1. Diplomë universitare në edukim fizik/sport;
 - 2.2. Diplomë/certifikatë për trajner në përputhje me nivelin përkatës të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, të lëshuar nga një institucion i akredituar nga agjencitë përkatëse në Republikën e Kosovës;
 - 2.3. Licencë valide nga organizatë kombëtare/ndërkombëtare e basketbollit ose institucion i huaj i njohur;
 - 2.4. Dëshmi për seminare të kandidati/ja i ka ndjekur.
2. Të mos ketë të ndaluar ushtrimin e veprimtarisë sipas ligjit në Kosovë;
3. Të jetë anëtarë i SHTBK-së;



4. Të ketë përvojë praktike minimale sipas nivelit të licencës;
5. Të paraqesë certifikatë mjekësore për aftësi fizike e psikologjike;
6. Të dorëzojë deklaratë të nënshkruar për mbrojtje të fëmijëve (Safeguarding);
7. Të paraqesë vërtetim nga Gjykata që nuk është nën hetim/nuk ka aktgjykim të formës së prerë;
8. Të kryejë pagesën vjetore sipas përcaktimeve të SHTBK-së dhe FBK-së.

KAPITULLI II: KATEGORITË DHE NIVELI I LICENCAVE

NENI 4: KATEGORITË E LICENCAVE

Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), në bashkëpunim me Shoqatën e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK), lëshon licenca për trajnerë sipas niveleve të përcaktuara më poshtë:

1. Licenca A - Trajner Elitar

Kjo licencë u jepet trajnerëve që udhëheqin ekipe në Superligën e Meshkujve/Femrave dhe ekipet nacionale të Kosovës.

- Trajneri elitar është i detyruar të ketë kontratë pune ose kontratë profesionale me klubin.
- Veprimtaria e tij duhet të jetë e regjistruar si profesion primar.
- Licenca A është e vlefshme për një edicion garues.

2. Licenca B - Trajner Kombëtar

Kjo licencë vlen për trajnerët që punojnë në Ligën e Parë dhe Ligën e Dytë të Kosovës.

- Kërkohet përvojë e mëparshme me grup-mosha ose asistent në ekipe seniore.
- Licenca është e vlefshme për një edicion garues.

3. Licenca C - Trajner i Grupmoshave

Licencë e përcaktuar për trajnerët që punojnë me grup-mosha U14, U16, U18 dhe ekipe të reja.



- Kjo licencë është hyrëse në karrierën e trajnerit dhe shërben si bazë për avancim në nivel më të lartë.
- Vlefshmëria e saj është një edicion garues.

4. Asistent Trajner

Për çdo kategori të mësipërme (A, B, C), klubi mund të kërkojë edhe licencim për një Asistent Trajner i cili duhet të plotësojë kushtet bazike të licencimit dhe të marrë pjesë në seminarët respektive.

- Asistent trajnerët nuk mund të figurojnë si trajnerë kryesorë në dokumentacionin zyrtar të FBK-së.
- Asistent trajnerët që janë pjesë e ekipeve të Superligës M/F duhet të kenë kontratë me klubet ku e ushtrojnë veprimtarinë.

NENI 5: PROCEDURAT PËR APLIKIM DHE LËSHIM LICENCE

1. Aplikimi bëhet nga trajneri apo klubi, përmes SHTBK-së, sipas kushteve të kësaj Rregullore dhe duke dorëzuar dokumentacionin e përcaktuar nga FBK nëpërmjet SHTBK-së.

2. Për trajnerët duhet të zhvillohet provimi teorik dhe praktik, organizuar nga SHTBK në koordinim me FBK.

3. Licenca lëshohet për një edicion garues dhe rinovohet pas përmbushjes së kushteve.

4. Trajnerët e huaj duhet të paraqesin licencë zyrtare, përvojë të dokumentuar ndërkombëtare dhe dokumente të tjera relevante.

NENI 6: MBROJTJA E KONTRATËS SË TRAJNERIT

Qëllimi dhe e drejta për mbrojtje

Ky nen ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e trajnerëve ndaj mosrespektimit të obligimeve kontraktuale nga ana e klubeve sportive veçanërisht në rastet e mos-pagesës së kompensimit të paraparë për edicionin e kaluar garues.

Të drejtë për të iniciuar procedurën e mbrojtjes e kanë vetëm trajnerët që:

- Posedojnë kontratë pune ose kontratë profesionale të nënshkruar me klubin;
- E kanë deponuar këtë kontratë në FBK/SHTBK përpara fillimit të edicionit përkatës;



- Kanë respektuar obligimet e tyre profesionale gjatë periudhës së kontratës.

Paraqitja e kërkesës

- Kërkesa për mbrojtje të kontratës duhet të dorëzohet me shkrim drejtuar Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së brenda 30 ditësh nga përfundimi i edicionit garues;
- Kërkesa duhet të përfshijë: kopjen e kontratës, dëshmitë e punës së kryer dhe deklarin e pretendimeve financiare.

Organet kompetente

- Shkalla e parë e vendimmarrjes është Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së;
- Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv.

Afatet procedurale

- Vendimi i shkallës së parë duhet të merret brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimi të kërkesës së plotë dhe komunikohet me arsyetim të plotë tek palët;
- Palët kanë të drejtë ankese ndaj vendimit të shkallës së parë brenda 8 ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

Zbatimi i vendimit dhe pasojat për klubin

- Nëse kërkesa e trajnerit aprovohet, klubi i detyrohet të përmbushë detyrimet financiare brenda një afati maksimal prej 10 ditësh pune nga data e marrjes së vendimit;
- Klubi që nuk përmbush vendimin e formës së prerë nuk ka të drejtë të licencojë trajnerë për sezonin pasues derisa të përmbushin detyrimin financiar dhe mund t'i nënshtrohet edhe sanksioneve të tjera të përcaktuara nga FBK.

Bashkëpunimi dhe dokumentacioni

- Të gjitha palët e përfshira në procedurë (trajneri, klubi, SHTBK, FBK) kanë obligim të bashkëpunojnë dhe të përgjigjen ndaj çdo kërkesë për dokumentacion brenda 5 ditësh pune;
- Mosbashkëpunimi konsiderohet si shmangie nga procesi dhe mund të ndikojë në vendimin përfundimtar të organit kompetent.



KAPITULLI III: OBLIGIMET, DISIPLINA DHE SANKSIONET

NENI 7: OBLIGIMET E TRAJNERËVE

1. Trajnerët kanë për obligim:

- 1.1.** Të respektojnë etikën, rregullat dhe aktet normative të FBK-së dhe SHTBK-së, me theks të veçantë Rregulloren Disiplinore të FBK-së, Kodin Etik dhe Politikat e Mbrotjtjes së FBK-së, duke u familjarizuar dhe pranuar të gjitha obligimet që rrjedhin nga to.
- 1.2.** Të mbrojnë reputacionin e FBK-së dhe SHTBK-së.
- 1.3.** Të marrin pjesë në seminare dhe programe të edukimit të vazhdueshëm.
- 1.4.** Të respektojnë rregullat e anti-dopingut dhe parimet e "fair-play".
- 1.5.** Të raportojnë për çdo parregullsi të FBK dhe SHTBK.

NENI 8: KUFIZIME

- 1.** Një trajner i licencuar ka të drejtë të udhëheqë jo më shumë se 2 ekipe (p.sh. 2 gjenerata) brenda një klubi/shkolle.
- 2.** Të gjithë trajnerët që kanë qenë pjesë e ndonjë përfaqësuese të Kosovës dhe regjistrohen në platformën e FIBA MAP, ju takon licenca për trajner.
- 3.** Të gjithë trajnerët duhet të i jenë nënshtruar apo të i nënshtrohen testit të FIBA WABC për Nivelin 1.

NENI 9: PEZULLIMI DHE REVOKIMI I LICENCËS

1. Pezullimi i licencës bëhet kur:

- 1.1.** Licenca është siguruar në bazë të dokumenteve të falsifikuara apo informacionit tjetër jo të vërtetë;
- 1.2.** Shkelen dispozitat e përcaktuara me Ligjin për Sport në fuqi në Republikën e Kosovës;
- 1.3.** Kriteret e përgjithshme sipas kësaj Rregullore nuk mund të konsiderohen më si të përmbushura.

- 2.** Pezullimi ka karakter të përkohshëm, ku trajnerit i ofrohet mundësia për të përmirësuar shkeljen e konstatuar nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin e përcaktuar nga FBK, nëpërmjet SHTBK.



3. Në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve apo mos-bashkëpunimit, trajnerit apo i revokohet licenca.
4. Kundër vendimit për revokim të licencës nga paragrafi 3 i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtuar Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së dhe atë brenda 7 ditë nga pranimi i vendimit për revokim përmes postës elektronike.
5. Për më shumë, në rast se trajnerit i është shqiptuar dënim nga organet disiplinore përkatëse të FBK-së, të njëjtit i pezullohet licenca deri në zbatimin e dënimit të shqiptuar. Në rast të dënimit ndalim i përhershëm, trajnerit i revokohet licenca.
6. Pezullimi mund të rezultojë edhe nga moskryerja e pagesës vjetore të përcaktuar nga SHTBK dhe FBK për ushtrimin e funksionit si trajner.

KAPITULLI IV: DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 10: HYRJA NË FUQI, ZBATIMI DHE NDRYSHIMET

1. Të gjithë trajnerët që ushtrojnë aktivitetin e tyre në kuadër të Federatës së Basketbollit të Kosovës janë të detyruar ta respektojnë këtë Rregullore si dhe të gjitha aktet e tjera normative të FBK-së dhe të Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK).
2. Implementimi i kësaj Rregulloreje bëhet nga SHTBK në bashkëpunim me strukturat përkatëse të FBK-së. Organet përgjegjëse janë të obliguara të monitorojnë zbatimin e saj dhe të raportojnë për çdo shkelje.
3. Çdo ndryshim plotësim apo interpretim zyrtar i kësaj Rregulloreje mund të bëhet vetëm me vendim të Bordit të FBK-së dhe hyn në fuqi pas miratimit dhe publikimit zyrtar në ueb faqe të FBK-së.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet paraprake që bien ndesh me të.
5. Kjo Rregullore është e harmonizuar me Statutin e FBK-së dhe me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

E miratuar në Prishtinë më 20.08.2025

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar
Federata e Basketbollit të Kosovës

